Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**27.03.2024**	**06.04.2024**	**2024/0254**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **22.03.2024**, OE: **"Mobelland" SH.P.K.- Suharekë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0254**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE: **Lot 1 dhe Lot 3 - Wood Corporation L.L.C.; Madekos Sh.p.k. - Suharekë, kurse per Lot 2: GOE Prime Corporation L.L.C. ; Erzeni Sh.p.k. - Malishevë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me mobilje"** me nr. të prokurimit: **"UA/2016-23-14297-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **– Agjencia Qendrore e Prokruimit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **Lot 1: 185,000.00€; Lot 2: 530,000.00 €; Lot 3: 2,250,000.00 €**.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë NUK është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Neni 1 i LPP-së

Neni 2 të LPP-së

Nenin 6 të LPP-së

Neni 7 i LPP-së 3/3

Neni 27 te LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 52 par. 3 te LPP-së

Neni 56 par. 3 te LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 par. 1.1 te LPP-së.

Neni 72 i LPP-së

Neni 4 i Rregullorës nr. 001/20

Neni 4 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 19 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 39.5 të Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurim Publik Neni 39.11 të Rregullore Nr.

001/2022 për Prokurim Publik Neni 40 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 41 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 45.19 të Rregullores Nr.

001/2022 për Prokurim Publik Neni 45.20 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim

Publik Neni 45.21 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin në fjalë në të cilin ka paraqitur kërkesat për pjesëmarrje si dhe ka paraqitur kriterin për dhënie i cili ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, ndërsa ne si Operator Ekonomik i jemi përgjigjur ftesës së AK-s për tender duke e përgaditur tenderin dhe duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ana e tyre.

AK – Agjencia Qendrore e Prokurimit me date 06.03.2024, përmes platformës elektronike e-prokurim ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK – B058, mirëpo me rastin vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te tenderëve tek kërkesa mbi mundësit

teknike dhe/ose profesionale për kërkesën 2/ dëshminë 2 te FDT-se, Katalogu na eliminon ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se, ne vijim do ti paraqesim argumentet tona ne lidhje me shkeljet te cilat i kemi gjetur ne vlerësimin jo të drejtë të AK-së:

Pasi kemi kontrolluar vendimin e autoritetit kontraktues B58, për dhënie të kontratës, si dhe pasi kemi pranuar letrën standarde me të cilën jemi njoftuar si tenderues i eleminuar, duke u bazauar në nenin 10 të LPP-s kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik me ç'rast AK na ka dhënë qasje në disa nga dokumentet e kërkuara, por ne deklaratat nën betim të komisionit të vlerësimit nuk na ka dhënë qasje edhe përkundër që ne e kemi bërë të qartë në kërkesën tonë që të na dërgohen deklaratat në mënyrë që të vlerësojmë ecurinë e procesit të vlerësimit. Andaj konsiderojmë që nuk na është dhënë qasja e plotë në përputhje me nenin 10 të LPP-s. Në lidhje me këtë qështje gjatë shqyrtimit të pretendimit tonë AK ka konstatuar se deklaratat nën betim nuk lejohet që të jepen në këtë fazë gjë e cila nuk është e vërtetë pasi që sipas nenit 10 një gjë e tillë është e lejuar.

Si arësyetim që jemi eleminuar kemi vërejtur që AK pretendon që nuk kemi plotësuar kërkesën 2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Katalogu të dosjes së tenderit dhe theksojnë që meqë keni dorëzuar kataloga ku ceket "devijimin e lejuar në dimension /-5% Me këtë rast nuk konsiderohet si katalog i rregullt ai katallog i cili përmban devijime në dimensione. Lejimi prej /- 5% tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit është për kohën e ofertimit. Pra, secili OE ka pasur mundësi të ofertoj me produkte të cilat kanë mundur të kenë një devijim prej /-5% nga dimensionet e paraqitura në Aneksin nr. 1 por përfshirja e këtij devijimi në katalog nuk ka kuptim dhe konsiderohet si variant gjatë realizimit të kontratës, andaj bazuar në pikën 4.1 të FDT-së, variantet nuk lejohen. Për të njejtën kërkesë AK gjithashtu keni dorëzuar katalog i cili përfshinë më shumë produkte se kërkesat e dosjes së tenderit, si dhe nuk keni ofruar katalog të ndarë për Lotet që keni ofertuar, me këtë rast ju kanë kërkuar sqarime shtesë që të ndaj artikujt për secilin Lot dhe i njëjti ka ofruar katalogun e njejtë duke plotësuar me disa shenja (shënuar me laps kimik) se cilët artikuj janë për cilin Lot dhe cilin pozicion por përsëri duke ofruar katalog të pa qartë dhe për më tepër për Lot 3 nuk keni ofruar asnjë sqarim lidhur me kërkesën e që ju është kërkuar. Edhe pas sqarimeve është vlerësuar katalogu përveq që përmban devijimet prej /- 5 % gjithashtu nuk është katalog i qartë duke i pamundësuar komisionit vlerësimin e duhur të këtij katalogu dhe me këtë rast oferta juaj është vlerësuar e pa përgjegjshme.

Konsiderojmë që konkluzioni i Autoritetit Kontraktues i paraqitur më lartë është vetëm arësyetim fiktiv me të cilin Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të tenderit, duke parë që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe kemi ofruar çmimin e tenderit më të lirë në mesin e ternderuesve të

përgjegjshëm pjesëmarrës për pjesën e parë me qëllim që të na diskualifikon neve nga tenderi në fjalë dhe kontratën t'ia jep ndonjë O.E. të paracaktur, na eleminon neve nga ky tender. Gjithashtu duke parë që O.E. të shpërblyer me kontratë kanë ofruar tender të pa përgjegjshëm duhet të merrej parasysh tenderi jonë si tenderues që i ka plotësuar të gjitha kërkesat edhe të shpërblehemi ne me kontratë edhe për pjesën 3.

Por AK, me qëllim që të na diskualifikon neve nga tenderi në fjalë na eleminoni neve nga ky tender dhe shpërblen me kontratë O.E. të cilët kanë ofruar tender dukshëm më të shtrenjtë se oferta jonë për pjesën e parë, ndërsa për pjesën 3 ka shpërblyer me kontratë O.E. të pa përgjegjshëm.

Autoritet Kontraktues në dsoje të tenderit në aneksin I të dosjes së tenderit ka paraparë që: Devijimi i lejuar në dimension është - 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuara më poshtë dhe komfor standardeve. Fotot janë vetëm për ilustrim, obligative është të plotësohet kërkesat e paraqitura tek "përshkrimi" Pra në bazë të kërkesës së AK-s, tek katalogu janë nënvizuar artikujt të cilët i kanë plotësuar 100% specifikat minimale të përcaktuar nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe i është lënë mundësia e devijimit prej - 5 % sikur është kërkuar nga vetë AK. Mirëpo, AK – komisioni i vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve me rastin e eliminimit te ofertës tonë me arsyetimin se "KATALOGU I CILI PERMBAN DEVIJIMET NE DIMENSIONE /-5% DHE LEJIMI I DEVIJIMEVE TEK ANEKSI 1 I DOSJES SE TENDERIT ESHTE VETEM PER KOHEN E OFERTIMIT, DHE PERFSHIRJA E KETYRE DIVIJIMEVE /-5% NE KATALOG NUK KA KUPTIM DHE KONSIDEROHET SI VARIANT GJATE REALIZIMITTE KONTRATES, ANDAJ BAZUAR NE PIKEN 4.1 TE FDT-së, VARIANTET NUK LEJOHEN" Por një gjë të tillë AK nuk e ka dhënë në kërkesën apo edhe nuk e ka shpjeguar tek dosja e tenderit apo njoftimin për kontratë **që devijimi /-5% është vetëm për kohën e ofertimit.** Prandaj, duke marr për baze faktet dhe argumentet qe AK e ka specifikuar ne aneksin 1 tedosjes se tenderit se lejohet devijimi /-5% dhe ne kemi vendosur edhe ne katalog ketë kërkesë te dosjes se tenderit, nuk përmban ndonjë variant, ashtu siç pretendon AK por është lënë mundësia e devijimit sipas kërkesës së AK-së.

Komisioni i vlerësimit duke u thirrur ne piken 1.4 te FDT-se gabon, sepse specifikimi teknik është pjese e kontratës dhe nuk qëndron arsyetimi i komisionit të vlerësimit se kjo vlen vetëm për fazën e vlerësimit, por jo edhe për fazën e ekzekutimit te kontratës, sepse kjo s'ka mundësi te ndodh, sepse kontrata rrjedh nga tri pjesët e dosjes se tenderit Pjesa A, B, dhe C (ne faqen e parë të dosjes se tenderit) si dokument themelore për përgatitjen e tenderëve nga OE sepse çdo fjali në dosjen e tenderit duhet të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Në nenin 28 të LPP-s dhe në nenin 19 të Rregullave të Prokurimit në pikën 19.10 është paraparë që vetëm për kriterin e dhënies tenderi ekonomikisht më I favorshëm mund të lejohen variante, andaj me qenë se ju keni paraparë kriterin tenderi I përgjegjshëm me çmimin më të ulët është i pa bazë arsyetimi juaj se vendosja e devijimit në katalog prej /- 5 % paraqet variant sipas nenit 4.1 të FDT-së.

Ky arsyetimi i eliminimit nga AK- Komisioni i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderëve është ne kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes, kriterin e dhënies dhe ne kundërshtim me aneksin 1 te dosjes se tenderit, sepse nuk ka dispozite ligjore te LPP-se, qe e

mbështet një veprim dhe arsyetim te komisionit te vlerësimit se "kjo vlen vetëm për fazën e vlerësimit por je dhe për fazën e ekzekutimit te kontratës".

PROVE: Kontrata qe ne kemi nënshkruar pikërisht me AQP me nr. AQP-20-0005-111 me nr. protokolli: 17/21 date 10.06.2021, dhe po ne ketë kontrate kemi dorëzuar KATALOGUN ku edhe ne atë specifikacion teknik aneksin 1 te FDT-se është lejuar devijim /- 10% dhe NE në katalog kemi dorëzuar sikurse qe tani kemi dorëzuar katalogun me devijime te lejuara nga AK dhe kemi lidhe kontrate dhe është ekzekutuar/realizuar/përfunduar dhe në fund kemi marrë referencën për realizim me sukses të kontratës në fjalë.

Pavaresishet kësaj ne kemi dhene sqarime ne letren standarde te kerkeses per sqarim, duke i nënvizuar me kimik per te ja lehtësuar edhe me shume komisionit te vlersimit edhe pse ska qene fare e nevojshme se katalogu ka qene shume i qerte, i sakt per secilin artikull me dimension, foto dhe përshkrim detal sikurse ne Aneksin a te FDT-se, por ne dyshojm me te drejt me fakt dhe prova se komisioni i vlerësimit nuk ka respektuar detyrat dhe pergjegjsit qe ka vlerësimin e drejt dhe sipas dosjes se tendeirt si dokument themelore per pergatitjen e tendereve nga OE, por perveq kësaj qe thote: "katalogu nuk eshte i qarte duke i pamundësuar komisionit te vlerësimit vlerësimin e duhur" qe argumenton pretendimin tone se komisioni i vlerësimit edhe vete e pranon se nuk ka qene professional me aftësi dhe pervoj te duheur per kete AP, duke ja shtuar edhe piken ne eleminimin tone se kinese devijimi /-5% permban variante dhe eshte e ndaluar sipas pikes 1.4 te FDTse, gje qe nuk qendron ashtu siç u sqarua edhe me lart, se ne kemi nenshkruar kontrat po me AQP ne vitin 2021 dhe varientet perdoren vetem tek kriteret ekonomikisht te favore dhe jo tek cmimim me i ulet kjo ka qene e ditur ne dosje tenderit dhe kete arsyetim komisioni i vlerësimit nuk ka te drejt ta perdore dhe te thirret sepse ne konsiderojmë se kjo eshte bere me mendim te na vene ne lajthitje dhe bindur se kinese nuk jemi te pergjegjshem, gje qe nuk qendron, sepse ka mjaft prova dhe argumente se komisioni I vlerësimit nuk ka respektuar nenin 1, 2, 6, 7, 59 dhe 60 te LPP-së.

Me fjale tjera, katalogu yne eshte ne pajtim te plote me kerkesnn2/deshemin 2 te FDT-se, sepse nuk posedon opsione por eshte pergaditur ne përputhje te plote me aneksin 1 te dosjese se tenderit, duke përfshinë të gjitha specifikat e produktit me te cilat kemi ofertuar pasi qe kemi përgatitur katalog te qarte, sakt dhe me kuptim te detajuar per artikujt me te cilet kemi ofertuar ne kete aktivitet te prokurimit, andaj komisioni i vlerësimit me rastin e eliminimit tone ka vepruar ne kundërshtim me nenin 52 par. 3 te LPP-se, pasi qe AK ka percaktuar kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit te cilat mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës, por jo kritre te cilat nuk jane percaktuar ne dosje te tenderit.

Gjithashtu, AK – Komisioni i vlerësimit ka vepruar edhe ne kundërshtim me me nenin 56 par. 3 te LPP-se, ku thote, po citojm: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkes ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e Tenderit" **qe dotethote se me arsyetimin e eleminimit ne raportin e vleresimit te dates 06.03.2024 kavepruar ne kundershtim me këtë dispozite ligjore duke dhënë arsyetime dhepershkrime te pa sakta duke na perjashtuar nga ky aktivitet i prokurimit mekerkesa dhe kritere qe nuk jane cekur ne dosje te tenderit si dokument themelor perpergadtijen e tenderve.**

Duke marr baze te gjitha keto fakte dhe argumnete te cilat i kemi parashtruar ne kete KpR me fakte dhe argugemnte te bazuar ne dispozita ligjore te LPP-se, kemi kërkuar nga AK – ZPP te konsultoj dispozitat ligjore, vleren e parashikuar per kete AP te kete parasysh nenin 1, 2 6 dhe 7 te LPP-se si dhe te te kete parasyshe parimin kryesore te prokurimit "Vleren per pare" dhe te respektoj nenin 31.1 te FDT-se qe eshte ne funksion te nenit 60 te LPPse, ne përputhje me njoftimin per kontrate dhe dosjen e tenderit pasi qe ne kemi arrit te plotesojm te gjithe kërkesat dhe kriteret e përzgjedhjes dhe kemi tenderuar me çmimin me te ulet te pergjegjshem ne kete aktivitet te prokurimit dhe bazuar ne dispozitat ligjore te LPP-se, AK ka per obligim te na rekomandoj per dhenie te kontrates. Por AK me rastin e shqyrtimit të kërkesës tonë nuk i mer fare për bazë këto dispozita dhe nuk e vlerësonë drejtë kërkesën tonë për rishqyrtim.

Te gjitha keto fakte dhe deshmi te ofruar nga ana jonë, jane profesionale dhe nuk mund te kontestehoen nga ansje ZPP – njohes i fushes se prokurimit sepse nuk ka logjik dhe as kuptim te jene ndryshe sepse shkelen standardet dhe rregullat profesional te LPP-se, prandaj arsyetimet e dhena nga ana jone jane te mbeshtetuar ne dispozite ligjore ashtu sic kemi potencuar ne KpR, duke i mundesuar AK – ZPP te aprovoj kerkesen tone per rishqyrtim krejt kjo ne funksion te qellimit te prokurimit per kete aktivitet te prokurimit.

PROVE: Konsultimi i dispozitave ligjore te LPP-së te faktuar dhe argumentuar ne KpR Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se AK – ZPP ka shkelur Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar ketë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Gjithashtu është e pa kuptimtë dhe jo profesionale pretendimi se për shkak se në katalog ka pasur artikuj më tepër se sa janë kërkuar në dosje të tenderit katalogu nuk është në rregull. Vetë termi "katalog" që e ka cekur AK si kërkesë në dosje të tenderit nënkupton ofrimin e artikujve të ndryshëm nga ana e prodhuesit me specifika të ndryshme të cilat mund ti zgjedh blerësi në bazë të dëshirës për të blerë një artikull të caktuar. Sikur ia kemi sqaruar në përgjigjen në sqarim të datës 23.02.2024 Në bazë të kërkesës së paraqitur nga ana e AK-s në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, **nuk është kërkuar që tëndahen katalogjet për secilën pjesë veç e veç por është kërkuar që të dorëzohetkatalogu si dhe nuk është kërkuar që të renditen pozicionet përkatëse Brendapjesëve.** Ndryshimi i katalogjeve pasi që është dorëzuar tenderi do të parqiste devijime të kushtit material dhe një gjë e tillë nuk është e lejuar në bazë të dispozitave të prokurkmit. Andaj me qëllim që të bëjmë më të lehtë vlerësimin e komisionit vlerësues dhe me qëllim që tia ofrojmë informatat e kërkuar, kemi nënvizuar secilin artikull që i plotëson specifikat teknike të kërkuara nga ana e AK-s si dhe pas kërkesës së tyre kemi cekur secilin artikull se cilës pjesë i takon dhe me cilin pozicion përshtatet. Por edhe përkundër faktit të lartcekur AK nuk merr për bazë kërkesën tonë por shpall me kontratë një O.E. me çmim më të lartë.

Autoriteti kontraktues duke vepruar në këtë mënyrë ka bërë shkelje të dispozitave të nenit1 të LPP-s pasi që ka refuzuar ofertën tonë e cila ka qenë ofertë më e lirë ndërsa dispozitat e këtij neni kanë paraparë që qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në bazë të këtyre dispozitave Autoriteti Kontraktues duhet ta merr vlerën për paranë e që oferta jonë do ta plotësonte një

kërkesë të tillë.

Pasi kemi analizuar dokumentacionin e tenderuesit "Wood Corporation" SH.P.K dhe Madekos SH.P.K të cilin AK ka vendosur që ta shpërblej me kontratë, vërejtëm se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të LPP-së gjatë vlerësimit, pasi që gjatë vlerësimit, nuk i ka zbatuar kërkesat të cilat vet Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin për furnizim me mobilje, ndërsa në pikën nr. 1 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka paraparë kërkesën si vijon: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara, jo me pak se Lot 1 200,000.00 Euro Lot 2 700,000.00 Euro Lot 3 3,000,000.00 Euro dhe si dëshmi ka kërkuar: Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo edhe nga blerësi privat.

" WOOD CORPORATION"L.L.C

Fabrika e Mobileve

Fatura : *95/2023*

Data : *26.09.2023*

Saler name	: " WOOD CORPORATION"L.L.C	Coustomer Name:	Komuna Deçan
No. businesses	: 811289562		
Address	: Zona Industriale- Suhareke		
Phone	: +383 45 101 880		

No	Përshkrimi Ezistimi	Njësia	Sasia	PA TVSH	TVSH	Total
					euro €	euro €
1	Inventarë	SET	1.00	12,118.84	2,181.96	50,000.00
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
					Total	50,000.00

08/02/2024, 00:04 Filiala e TEB-it në Internat

TEB TEB KOSOVA

Rr.Br?Gada 123, Pa Numer Therande 23000 PRIZREN

Dëftesë

Data : 22/09/2023
Nr : 00000941

Llogaria:20-25-0001670765-05
Dërguesi:1505021003200794
Marrësi:WOOD CORPORATION L.L.C.

Z OFFICE SH.P.K. FT232656VQZQ PAGES E FATURES NR 90/2023 EUR 10,000.00+
Data : 22/09/23

WOOD CORPORATION LLC

PAGES E FATURES NR 90/2023

EUR.10,000.00 kredituar në llogarinë tuaj

" WOOD CORPORATION"L.L.C

Fabrika e Mobileve

Fatura : 90/2023

Data : 22.09.2023

Saler name	: " WOOD CORPORATION"L.L.C	Countomer Name:	Z OFFICE SH.P.K.
No. businesses	: 811289562		811891186
Address	: Zona Industriale- Suhareke		Malisheve
Phone	: +383 45 101 880		N/A

No	Përshkrimi Emërtimi	Njësia	Sasia	PA TVSH	TVSH	Total
					euro €	euro €
1	Karrige	Copë	100.00	84.75	15.25	10,000.00
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
					Total	10,000.00

Katalogu i GOE të rekomanduar per pjesen e parë dhe të tretë nuk i përmbanë specifikat e kërkuara, pasi që grupi i O.E. kishte dorëzuar specifikat e kopjuara nga dosja e tenderit dhe ka vendosur nga nje vizatim teknik me një program për dizajn dhe arkitektur i cili quhet SKETCHUP dhe jo katalog me foto sikur është kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktues në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Pra si është e mundur që AK të marrë si të rregullt këtë katalo ndërsa katalogun tonë i cili është përgaditur në mënyrë profesionale duke ju

referuar kërkesës së AK-s në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë të cilësohet se nuk i ka përmbushur kërkesat e AK-së.

AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENC

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
811560293

Veprimtaritë / Activities / Delatnosti

8621	Aktiviteti kryesor i biznesit	Aktivitetet e mjekësisë së praktikës së përgjithshme General medical practice activities Delatnosti opće medicinske prakse
4690	Aktivitetet tjera	Tregtia me shumicë jo e specializuar Non-specialised wholesale trade Nespecijalizirana trgovina na veliko
8623	Aktivitetet tjera	Aktivitetet e dentistëve Dental practice activities Delatnosti stomatološke prakse
4773	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakice e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore) Dispensing chemist in specialised stores Apoteke
4646	Aktivitetet tjera	Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë Wholesale of pharmaceutical goods Trgovina na veliko farmaceutskim proizvodima
4774	Aktivitetet tjera	Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë, në dyqane të specializuara Retail sale of medical and orthopaedic goods in specialised stores Trgovina na malo medicinskim pripravcima i ortopedskim pomagalima u specijaliziranim prodavnicama

Shihet qartë që Autoriteti Kontraktues, duke e favorizuar O.E. të rekomanduar ka shkelur parimet bazike të prokurimit të cilat janë paraparë në nenin 4 të Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik sikur janë:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues. c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial. d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit. e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente. f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe

regjistrimin e të dhënave të nevojshme. g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira. Andaj favorizimi i një O.E. gjatë vlerësimit si dhe diskualifikimi i O.E. tjetër për kërkesa të cilat nuk kanë qenë të parapara në as në dosje të tenderit dhe as në nojftimin për kontratë paraqet shkelje të rëndë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të parapara në nenin 7 të LPP-së.

Gjithashtu, grupi nuk i kanë plotësuar edhe kërkesat e përshtatshmërisë pasi që anëtari i grupit Madekos SH.P.K certifikatën e regjistrimit të biznesit të lëshuar nga ARBK nuk kishte asnjë veprimtari për mobilje apo inventar, por të gjithë veprimtarinë e kishte për tregëti me pajisje të mjekësisë, dentare, artikuj farmaceutik ortopedik etj. të cilat mund të shihen nga certifikata e biznesit e paraqitur me rastin e e dorëzimit të tenderit. Shih foton më poshtë.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, AK ka bërë vlerësim jo të drejtë dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-s, pasi që na eleminon nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë të paracaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues. Në dispozitat e paragrafit **4 të nenit 59 të LPP-sshprehimisht është paraparë që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tendersi të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjithakërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.** Pra sikur shihet AK na eleminon për kërkesa të cilat nuk i ka paraqitur në dosje të tenderit dhe njoftimin për kotnratë. Andaj konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-s dhe Neni 40 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit, i cili në dispozitat e paragrafit 40.12 shprehimisht është cekur se: Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Ndërsa në paragrafin 40.13 ka paraparë që AK do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Andaj Autoriteti Kontraktues duke na eleminuar në mënyrë arbitrare ka bërë shkelje të këtyre dispozitave. Duke marr për bazë te gjitha faktet dhe provat lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, komisini i vlerësimit, ekzamnimit dhe krahasimit te tenderve me rastin e eliminimit tone ka shkelur nenin 59 par. 1 te LPP-se, dhe rregulloren 39.5 te RR. Nr. 001/2022 per PP sepse komisioni i vlerësimit duhet te posedoje aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit, dhe ne rastin te eliminim ka deshtuar duke vepruar ne kundërshtim me keto dispozite ligjre te LPP-se. Andaj kemi kërkuar NGA AQP TE APROVOJ KERKESN TONE DHE TI RESPEKTOJ KETO DISPOZITA LIGJORE DHE TE VENDOS KOMISIONIN PROFESIONAL ME AFTESIT E DUHURA, NJOHURIT DHE PERVOJEN. Por pavarisisht kësaj AK – AQP ka shkelur nenin 39.11 te Rr. Nr. 001/2022 PP, sepse nuk eshte dashur te pajtohet me komisionin e vlerësimit por, te asistoj dhe nese eshte nevoja edhe te ndryshoj komisionin e vlerësimit dhe te respketohet ne teresi dispozitat ligjore te LPP-së.

Autoriteti Kontraktues e ka bërë vlerësimin e tenderit në kundërshtim me nenin 59 të LPPs pasi që e ka cilësuar si të përgjegjshëm një O.E. i cili e ka dorëzuar një listë të projekteve të realizuara për pesë (5) projekte të cilat i ka futur në follderin me nr. 5 ndërsa për të gjitha projektet tjera nuk ka evidencë. Kërkesa për dëshmi e AK ka qenë Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, gjithashtu

Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo edhe nga blerësi privat. Ne follderat me numër 10 pjesa e pestë dhe me numër 11 pjesa e gjashtë janë vendosur dokumentet e njejta me qëlim të vënies në lajthim të Autoritetit Kontraktues per te rritur vlerën e referencave pasi që sikur kemi shpjeguar me lartë, grupi i Operatorëve ekonomik nuk e ka plotësuar kërkesën e Aks Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara, jo me pak se Lot 1 200,000.00 Euro Lot 2 700,000.00 Euro Lot 3 3,000,000.00 Euro Operatori ekonomik e ka vu në lathitje autoritetin kontraktues me rastin e paraqitjes së faturave fiktive te cilat nuk jane reale pasi qe qarkullimi i deklaruar ne ATK nuk perputhet me qarkullimin e projekteve te realizuara te cilat i ka paraqitur lideri i grupi O.E. Wood Corporation SHPK.

Duke u bazuar në nenin 106 të LPP-s, si dhe në rrethanat dhe faktet e cekura më lartë, kërkojmë nga OSHP që të urdhëroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht ta pezulloj aktivitetin e prokurimit në fjalë, të shqyrtoj faktet e paraqitura në ankesën tonë dhe pas vërtetimit të fakteve të cekura më lartë te merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e GOE: Mobelland SH.P.K.

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per dhenie te kontrates dhe lënda te kthehet ne RIVLERESIM dhe të urdhërohet Autoriteti kontraktues që gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave ligjore te LPP-së në mënyrë që të rishqyrtojnë vendimin me të cilin kanë propozuar për kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë se oferta jonë dhe të merren parasysh dokumentet e ofruara në tenderin tone.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues, kurse tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.2) Përshtatshmëriaprofesionale: **Dëshmia e kërkuar dokumentar.**

Kërkesa 1 Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;	**Dëshmia 1 Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatoritekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);**

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar **Dëshmia e kërkuar dokumentar.**

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të shkuara një xhiro totale në EURO minimum Lit 1 350,000.00 Euro Lot 2 1,000,000.00 Euro Lot 3 4,000,00.00 Euro	**Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e shkuara ose vërtetim të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK-ja mbi qarkullimin financiar në tri vitet e shkuara ose gjendje e përgjithshme të lëshuar dhe vërtetuar nga ATK.**

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional **Dëshmia e kërkuar dokumentar.**

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës se ngjajshme në 3 (tri) vitet e shkuara, jo me pak se Lot 1 200,000.00 Euro Lot 2 700,000.00 Euro Lot 3 3,000,000.00 Euro	**Dëshmia 1 Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit apo ndonjë format tjetër që përfshinë afërsisht te dhënat e aneksit 8 dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e tillë, gjithashtu Operatori Ekonomik për plotësimin e kësaj kërkesë mund te bashkëngjisë edhe Listë Libër të faturave të shitjeve (ku duhet të shihet qartë të paktën blerësi, data, artikujt dhe shuma duke ua bashkangjitur faturat si dëshmi) apo edhe duke paraqitur referenca si nga blerësi publik apo edhe nga blerësi privat.**
Kërkesa 2 Katalogu për produktet qe oferton	**Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë i sakët për produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsionie si minimum apo duhet të ketë... , pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog por duhet të ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni.**

Aneksi 1 **SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

Garancioni për secilin artikull është 12 muaj nga pranimi i mallit.

Devijimi i lejuar në dimension është +- 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuara më poshtë dhe komfor standardeve.

Fotot janë vetëm për ilustrim, obligative është të plotësohet kërkesat e paraqitura tek "përshkrimi"

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Grup i Operatorëve Ekonomik Mobelland SH.P.K.; IBM SH.P.K.; MBB Construction SH.P.K. nuk e ka plotësuar kërkesën 2 të lartcekur – "Katalogu" të dosjes së tenderit meqë ka dorëzuar katalog ku ceket "devijimin e lejuar në dimension +- 5 %". Me këtë rast nuk konsiderohet si katalog i rregullt ai katalog i cili përmban devijime në dimensione. Lejimi prej +/-5% tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit është për kohen e ofertimit. Pra, secili OE ka pasur mundësi të ofertoj me produkte të cilat kanë mundur të kenë një devijimi prej +/-5% nga dimensionet e paraqitura në Aneksin 1, por përfshirja e këtij devijimi në katalog nuk ka kuptim dhe konsiderohet si variant gjatë realizimit të kontratës, andaj bazuar në pikën 4.1 të FDT-së, variantet nuk lejohen.
Për të njëjtën kërkesë GOE ka dorëzuar katalog i cili përfshinë më shumë produkte se kërkesat e dosjes se tenderit, si dhe nuk ka qenë i ndarë katalogu për Lotet, me këtë rast ju kanë kërkuar sqarime shtesë që të ndaj artikujt për secilin Lot dhe i njëjti ka ofruar katalogun duke plotësuar me disa shenja (shënuar me

laps kimik) se cilët artikujt janë për cilin Lot dhe cilin pozicion. Edhe pas sqarimeve kemi vlerësuar se katalogu i dorëzuar përveç që përmban devijimet prej +/-5% gjithashtu nuk është katalog i qartë duke i pamundësuar komisionit vlerësimin e duhur të këtij katalogu.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"Mobelland" SH.P.K.**

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ku GOE ankues është eliminuar nga AK sa i përket "katalogut" meqë keni dorëzuar katalog ku cekët: "Devijimin e lejuar ne dimensione +/- 5%, ku konsiderohet si variante gjate realizimit te kontratës, andaj bazuar ne piken 4.1 te FDT-së, variantet nuk lejohen dhe me këtë rast oferta juaj për Lot 3 është vlerësuar e papërgjegjshme. **Prove:** Kontrata me AQP me nr. AQP-20-0005-111 me nr. protokol. 17/21 te datës 10.06.2021 katalogu me devijime +/-10%.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dosjen e tenderit, konkretisht Aneksin 1 specidikimi teknik i detyrushem, si dhe bazuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 të FDT-së**, si në vijim:

Kërkesa 2 Katalogu për produktet qe oferton	Dëshmia 2 Katalogu për produktet qe oferton - Katalogu duhet të jetë produktet që ofertoni. Nuk lejohet të ketë opsionie si minimum apo duh , pra nuk mund të shfrytëzohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit si katalog p ofrohet katalog që përfshinë të gjitha specifikat e produktit të cilin e ofroni.

OE anketues ka dorëzuar, prezantuar "katalogun" te nënshkruar dhe te vulosur nga kompani, duke vendosur tek përshkrimi i **"Për cdo dimesion lejohet +/- 5 %" qe do te thote se eshte ne kundershtim me kerkesen2/deshmin 2 te FDT-se, pasi qe paraqet opsion dhe kjo ka qene e ndaluar sipas kerkese me larte te dosjes se tenderit (sqarim: *Devijimi i lejuar +/-5 % nenkupton se OE me rastin e pergaditjes se katalugut ka mundur te paraqet ndryshime ne devijim ne secilin pozicion deri ne +/- 5%, por jo te vendos ne katalog per cdo dimesiona lejohet +/-5%, pasi qe kjo paraqet opsione dhe kjo ka qene e nduar me deshmin 2 te dosjese se tendeirt si me larte*), andaj** AK - Komisionit te vlerësimit ka vepruar ne pajtim me **nenit 59 par. 4 të LPP-së**, ku thotë: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit",* që do të thotë se arsyetimi ne raportin e vlerësimit, letrën standard te eliminimit dhe refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me kete pikë janë ne pajtim dispozitaat ligjore te LPP-së, sepse vlerësimi i tenderëve nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave administrative dhe teknike të parashtruara në dosje te tenderit. Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nukjanë të qëndrueshëm.**

Përgjigje në pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, ku GOE te rekomanduar për dhënie te kontratës për **Lot 1** është i papërgjegjshëm për arsye si ne vijim:

1. Kontratat dhe referencat e prezantuar nga Madekos shpk janë pajisje mjekësore dhe nuk hyn ne kategorinë e inventarit-mobileve dhe janë ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit.

2. Deklaratat e dorëzuara ne ATK me vërtetimin e qarkullimit te bankës qe nen kupton se lideri i grupit ka paraqitur fatura fiktive; fatura e paraqitur ne foto dhe llogaria e bankës janë te manipuluara.

3. Katalogu i GOE te rekomanduar për kontrate ka kopjuar nga dosja e tenderit dhe ka vendosur një

vizatim teknik me një program për dizajn dhe arkitektura i cili quhet SKETCHUP dhe jo katalog me foto.

4. Anëtari konsorciumit Medekos shpk merret me barna mjekësore dhe veprimtaria ARBE nuk ka asnjë aktivitet te inventarit – mobile.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate, OE ankues nuk ka specifikuar saktë duke ofruar prova dhe argumente konkret, por vetëm ka përshkruar duke supozuar, p.sh.

1. OE ankues nuk i ka cekur cilat kontratë konkretisht pasi aty janë disa andaj ESH e ka te pa mundur te di çka ka mëndu OE ankues dhe për cilat kontrata e ka pas fjalën!.

2. Po ashtu, OE ankues ka ngritur pretendim për Deklarimet ne ATK, mirëpo për manipulime dhe falsifikim OE ankues mund ti drejtohet organeve kompetente, pasi qe ESH nuk është kompetent te trajtoj këto çështje!.

3. Pretendimi i OE ankues se ka kopjuar fotot, përveç fotove është edhe përshkrim teknik i cili është ne përputhje me aneksin 1 te dosjes se tenderit, andaj fotot janë sa për ilustrim, po ashtu OE ankues nuk ka specifikuar konkretisht cili artikull apo cili pozicion nuk përputhet me kërkesat e dosjes se tenderit.

4. Anëtari i konsurciumi Madekos, nëse referohemi kërkesës se dosjes se tenderit është kërkuar vetëm NUI por jo edhe kodet apo fushe veprimtari e biznesit!.

Prandaj, pavarësisht këtyre sqarimeve si me larte, edhe pse OE ankues nuk ka specifikuar dhe ofruar fakte dhe argumente ESH edhe pas analizimit dhe hulumtimit te dokumenteve te prezantuar nga GOE te rekomanduar për kontrate, nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi qe bie ndesh me kriteret e përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje tenderit – aneksin 1 te dosjes se tenderit, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë për piken 3 pretendimi ***<u>është pjesërisht i qëndrushëm</u>***kurse për pikat tjera **nuk janë të qëndrueshëm.**

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **ka respektuar nenin 7, 59 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe të gjeturat tjera në këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të ***aprovohet si pjersisht e bazuar*** (*për arsyen që u cek tek përgjigja nëpretendimin me nr. 2*), *dhe të njëjtin tender për* ***Lot 1,*** **Lot 2 dhe Lot 3** **r***ekomandojmë që të* ***mbete në fuqi vendimi i AK*** *lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.*

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"Mobelland" SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Sahit Beqiri